VENDIM
Nr. 301, datë 11.5.2022

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË ARABISË SAUDITE, PËR NJOHJEN E NDËRSJELLË TË LEJEVE TË DREJTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË TË ARABISË SAUDITE MBI NJOHJEN E NDËRSJELLË TË LEJEVE TË DREJTIMIT

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Arabisë Saudite (më poshtë të quajtura "Palët");

në mbështetje të bashkëpunimit dhe marrëdhënieve të tyre miqësore;

me dëshirën për të vendosur një bashkëpunim të frytshëm dhe afatgjatë në reciprocitetin e lejeve të drejtimit; dhe

duke kuptuar përfitimet e ndërsjella që vijnë nga ky bashkëpunim,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Secila palë njeh lejet e drejtimit të vlefshme dhe jo të përkohshme, të lëshuara nga autoritetet kompetente të Palës tjetër për shtetasit e tyre, në pajtim me legjislacionin dhe rregulloret e tyre të zbatueshme. Kjo njohje përfshin përdorimin dhe shkëmbimin e këtyre lejeve drejtimi.

Neni 2

1. Çdo person, mbajtës i një leje drejtimi, të lëshuar nga autoritetet kompetente në vendin e tij, i jepet një leje drejtimi e barasvlershme, e lëshuar nga autoritetet kompetente në vendin tjetër, pa iu nënshtruar provimeve teorike dhe praktike. Megjithatë, kjo leje drejtimi duhet të jetë e vlefshme sipas ligjeve të zbatueshme të Palës që ka lëshuar lejen e drejtimit për personat që kanë një vizë pune. Pala tjetër duhet të njoftohet për lëshimin e kësaj leje drejtimi.

2. Një shtetas i cilësdo Palë, që ka marrë një vizë hyrjeje në vendin e Palës tjetër, do të lejohet të drejtojë mjete private, me kusht që ai të ketë një leje të vlefshme drejtimi të lëshuar nga autoriteti kompetent në vendin e tij. Bëjnë përjashtim nga kjo lejet e përkohshme të drejtimit. Leja e drejtimit mbetet e vlefshme deri në datën e saj të skadimit ose deri në datën e skadimit të lejes së qëndrimit, cilado qoftë më parë, me kusht që periudha e përgjithshme të mos kalojë një vit nga data e hyrjes në vend.

3. Çdo anëtari të një misioni diplomatik mund t'i lëshohet leje drejtimi, pa pasur nevojë të japin një provim, duke paraqitur një kërkesë me shkrim për Ministrinë e Jashtme të Palës tjetër. Çdo anëtar, i cili nuk ka një leje drejtimi duhet të japë provimet e nevojshme të administruar nga autoriteti kompetent për marrjen e një leje drejtimi.

Neni 3

Drejtuesit e mjeteve mund të drejtojnë vetëm mjetet për të cilat kanë leje drejtimi sipas ligjeve të zbatueshme të autoritetit kompetent që ka lëshuar lejen e drejtimit.

Neni 4

Në rast se drejtuesi i mjetit shkel ligjet e trafikut kombëtar, ai do t'i nënshtrohet ligjeve të vendit ku ndodh shkelja.

Neni 5

Në rast se ndonjëra nga Palët, dyshon për vlefshmërinë dhe vërtetësinë e lejes së drejtimit, ajo do të kryejë një provim praktike ose do të kërkojë të konfirmojë vërtetësinë dhe vlefshmërinë e lejes së drejtimit duke kërkuar informacion nga Pala tjetër përmes kanaleve diplomatike. Pala së cilës i drejtohet kërkesa do t'i përgjigjet kërkesës brenda një periudhe jo më të gjatë se 60 ditë nga data e marrjes së saj.

Neni 6

Autoritetet kompetente të Palës përgjegjëse për zbatimin e kësaj Marrëveshje, janë:

Për Republikën e Shqipërisë:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, rruga "Muhedin Llagani", nr. 10.

Për Mbretërinë e Arabisë Saudite:

Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Sigurisë Publike/Departamenti i Trafikut).

Neni 7

Autoritetet kompetente të Palëve, të referuara në nenin 6, shkëmbejnë modelet e lejeve të drejtimit dhe një tabelë konvertimi për llojet e lejeve të drejtimit në të dyja vendet, si dhe çdo amendim të tyre.

Neni 8

1. Autoritetet kompetente të Palëve, kurdo që është e nevojshme, organizojnë takime me specialistët e tyre që të shkëmbejnë njohuritë në fushat që mbulohen nga kjo Marrëveshje.

2. Palët shkëmbejnë rregullore, publikime dhe studime që kanë lidhje me trafikun.

Neni 9

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me anë të konsultimeve të drejtpërdrejta ndërmjet autoriteteve kompetente të të dyja vendeve. Në rast se autoritetet kompetente nuk arrijnë të gjejnë një zgjidhje, mosmarrëveshja do të zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 10

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të ndryshohen me miratim të Palëve përmes negociatave të drejtpërdrejta ndërmjet autoriteteve kompetente në përputhje me procedurat e tyre të zbatueshme.

Neni 11

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi 30 ditë nga data e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim të shkëmbyer midis Palëve përmes kanaleve diplomatike që konfirmon se palët kanë përmbushur të gjitha procedurat e brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të saj.

Neni 12

1. Kjo Marrëveshje do të ketë një kohëzgjatje me afat të papërcaktuar.

2. Secila palë mund të kërkojë zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar palës tjetër kontraktuese, përmes kanaleve diplomatike. Në këtë rast, kjo Marrëveshje do të zgjidhet gjashtë muaj nga data e marrjes së këtij njoftimi. Kjo nuk do të ndikojë te kërkesat e dërguara gjatë periudhës së vlefshmërisë së Marrëveshjes.

Bërë në qytetin e Riadit, më 7.3.2022.....G, që i korrespondon datës 4.8.1443 Hijri, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, arabe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:
Olta Xhaçka
Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme

Për Qeverinë e Mbretërisë së Arabisë Saudite:
Abdulaziz bin'Saud bin Naif bin Abdulaziz
Ministër i Brendshëm